

1. Raportimi javor per perludhen 24 deri 30 Qershor 2019

Raporti i Katër javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: Eleonora Olli
Zgjedhjet: Per Kryetar Bashkie ne date 30 Qershor 2019
Partia/subjekti elektoral: Partia Aleanca Kuq e Zi (PAK)
Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara: Tirane, Kukes, Prrenjas

Shkeljet e mundëshme të identifikuara të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore

Zyrat elektorale

Nga 61 bashki te kontaktuara zyrtarisht, 44 bashki ose 72% e totalit jane pergjigjur me e-mail ose poste se :

Partia Aleanca Kuq e Zi nuk ka zyra elektorale ne territorin e Bashkise,
Partia Aleanca Kuq e Zi nuk ka derguar njoftim prane Bashkise per vendodhje te zyrave te saj elektorale,
Nga verifikimet ne terren te punonjesve te Bashkise nuk jane evidentuar zyra elektorale te Partise Aleanca Kuq e Zi.

Ne javen e kater te monitorimit eshte vazhduar komunikimi me kryetarin e partise Aleanca Kuq e Zi per te marre zyrtarisht listen e aktiviteteve te Partise Aleanca Kuq e Zi per fushaten zgjedhore Qershor 2019.

Monitoruesi nuk mundi te marre zyrtarisht listen e aktiviteteve te subjektit zgjedhor PAK deri ne daten e ketij raporti.

Ne komunikimin verbal (me telefon) me Kryetarin e Partise Aleanca Kuq e Zi, monitoruesi u informua se: Per fushaten zgjedhore ne 30 Qershor 2019, Partia Aleanca Kuq e Zi nuk ka liste ose plan te miratuar me aktivite te detajuara sipas bashkive ne vend. Subjekti zgjedhor PAK konkuron me liste shumëemeroje ne bashkite Kukes dhe Prrenjas dhe nuk ka planifikuar aktivite elektorale ose fonde per shpenzime per fushaten elektorale as ne keto bashki dhe as ne bashkite e tjera ne vend.

Nje nga kandidatet e rregjistruar ne listen shumeemeroje ne bashkine Prrenjas ka perdorur nje ambjent brenda shtepise se tij si vend per takime e pritje elektorale. Siperfaqja e ambjentit te perdorur eshte rreth 42 m2. Kosto mujore per qerane e ketij ambjentit e vleresuar bazuar ne VKM 469 date 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të qmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore" rezulton te jete rreth 5 200 leke.



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

Ne javen e kater jane monitoruar Bashkite : Tirane, Kukës, Prrenjas.

Gjate monitorimit nuk jane vene re shkelje ne lidhje me zyrat elektorale.

Materiale të fushatës të ndaluara

Ne javen e kater jane monitoruar Bashkite: Tirane, Kukës, Prrenjas. Gjate monitorimit nuk jane vene re shkelje ne lidhje me materialet e ndaluara te fushates dhe si rrjedhim nuk u evidentuan kosto të mundeshme per keto materiale.

Ne javen e kater te monitorimit ne qytetet Tirane, Kukës, Prrenjas nuk u evidentuan tubime ose mitingje zgjedhore te Partise Aleanca Kuq e Zi.

Ne javen e kater te monitorimit ne qytetin Prrenjas u vleresua se nje nga kandidatet e listes shumeemerore te subjektit zgjedhor ka kryer disa shpenzime per fushaten elektorale si p.sh.: Shpenzime per karburant, shpenzime per Fletepalosje dhe shpenzime per piqe. Kosto totale e ketyre shpenzimeve vleresohet te jete rreth 910 mije leke.

Tirane 30 Qershor 2019

Monitorues/ Eleonora Olli



Miraturar me VendimIn nr. 152 datë 11.04.2019